



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
AGJENCISË SË SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR PËR
VITIN 2019**

Prishtinë, Korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

“ETIKA Co” Shpk ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në konsultim me menaxherin e kontratës Mujë Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga ETIKA Co shpk, nga Faruk Prebeza, udhëheqës i ekipit si dhe Burim Selmani, anëtar i ekipit.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja.....	16
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	18

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore ishte menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli kishte kontrolle të mira në raport me obligimet statusore të saj. Megjithatë ne kemi vërejtur dobësi në klasifikimin e shpenzimeve, vonesa në realizimin e projekteve kapitale, prezantimi jo i drejtë i pasurive si dhe vonesa në pagesa.

ASHNA prej 4 rekomandimeve nga viti i kaluar, 2 kishte adresuar, 1 ishte mbyllur dhe 1 nuk ishte adresuar ende.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Menaxhmenti i ASHNA-së është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga ASHNA-ja. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Drejtori i ASHNA-së dhe Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i ASHNA-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ASHNA-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

ASHNA-ja kishte kontrolle të mira në raport me obligimet statusore të saj. Megjithatë ne kemi vërejtur dobësi në klasifikimin jo të drejtë të shpenzimeve, vonesa në realizimin e projekteve kapitale, prezantimi jo i drejtë i pasurive si dhe vonesat në pagesa.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	7,130,150	7,601,560	6,295,234	83%	3,729,812	3,581,634
Granti i Qeverisë - Buxheti	1,580,000	1,580,000	1,442,737	91%	423,016	376,618
Të hyrat e dedikuara	5,050,150	5,050,150	4,458,847	88%	3,306,796	3,205,016
Te hyrat nga AKP	500,000	971,410	393,650	41%	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 471,410€. Kjo rritje është rezultat i vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për mbulimin e shpenzimeve në projektet kapitale, mjete këto të ndara nga fondi i AKP-së.

Në vitin 2019, OB-ja ka shpenzuar 83% të buxhetit final ose 6,295,234€, me një përmirësim prej 13% krahasuar me vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale në nivel të kategorive ekonomike.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	7,130,150	7,601,560	6,295,234	83%	3,729,812	3,581,634
Pagat dhe Mëditjet	2,876,373	2,876,373	2,757,216	96%	2,543,064	2,276,854
Mallrat dhe Shërbimet	1,418,857	1,418,857	1,391,945	98%	669,249	555,879
Shërbimet komunale	102,370	102,370	98,721	96%	94,483	61,375
Investimet Kapitale	2,732,550	3,203,960	2,047,352	64%	423,016	687,526

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Kategoria e pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbime si dhe ajo e komunalive nuk kishte ndryshime buxhetore në raport me buxhetin fillestar; ndërsa
- Buxheti i investimeve kapitale ishte rritur në raport me buxhetin fillestar për vlerën 471,410€. Kjo rritje ishte me vendim të Qeverisë prej të hyrave nga AKP-ja.

Lidhur me regjistrimin e shpenzimeve në kode ekonomike, kemi identifikuar si në vijim:

Çështja B1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pika 3 (Inicimi i shpenzimeve) të Rregullës financiare nr. 01/2013 MF Shpenzimi i parasë publike - shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël.

Gjatë testimit kemi identifikuar që shpenzimet ishin keqklasifikuar në kategorie joadekuate si:

- Pagesa në vlerë prej 9,955€ për ndarjen e zyreve, ngjyrosja e mureve dhe vendosja e llasneve të ASHNA-së, ishte bërë nga mallrat dhe shërbimet, përkundër që kjo pagesë do të duhej të realizohej nga kategoria e investimeve kapitale;
- Pagesa 28,910€ për blerjen pajisjeve rezervë 4 copë power supply së bashku me instalimin e tyre në sistemet e radios VHF dhe UHV e cila ishte bërë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në emër të kontratës së mirëmbajtjes së sistemit VHF dhe UHV të radiokomunikimit, për nga natyra i takonte investimeve kapitale; dhe
- Pagesa 12,888€ për shërbime të sigurimit ishte bërë nga investimet kapitale përmes vendimeve gjyqësore e që për nga natyra ishte shpenzim i kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e planifikimeve jo të mira dhe vendimeve gjyqesore të ekzekutuara nga thesari.

Ndikimi Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë jo adekuate, ndikon në keqklasifikimin apo prezantimin e informatave jo të sakta për kategoritë ekonomike në PFV.

Rekomandimi B1 Drejtori duhet të siguroj që për të gjitha shpenzimet janë bërë planifikimet e duhura me kohë, në mënyrë që shpenzimi i tyre dhe regjistrimi të jetë në kategoritë e duhura ekonomike.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga ASHNA në 2019 ishin në vlerë 4,518,808€. Ato kanë të bëjnë me shërbimet terminale apo dhënies së shërbimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	-	-	4,518,808	4,001,872	3,302,654
Totali	-	-	4,518,808	4,001,872	3,302,654

ASHNA realizon të hyra të dedikuara duke ofruar shërbime të navigacionit ajror ndaj Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 2,876,373€, prej tyre ishin shpenzuar 2,757,216€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 170 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 168. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 18 të rinj. Kemi testuar 52 mostra për teste substanciale në vlerë 108,204€ si dhe 40 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 1,418,857€, prej tyre ishin shpenzuar 1,391,945€. Ndërsa buxheti final për komunalishte ishte 102,370€, prej të cilave ishin shpenzuar 98,721€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime të mirëmbajtjes së pajisjeve, shërbime të tjera kontraktuese, arsimit dhe trajnimit, sigurime të ndërtesave, shpenzime të udhëtimit, shërbimet komunale dhe shpenzime tjera. Kemi testuar 50 mostra për teste substanciale në vlerë 541,876€ si dhe 15 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Përveç çështjes B1 të trajtuar në nënkapitullin 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit, ne nuk kemi ndonjë çështje tjetër. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,203,960€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 2,047,352€. Ato kanë të bëjnë me furnizime të ndryshme të pjesëve të radarëve, sistemeve, pajisjeve të sigurisë, blerje të veturave, ndërtim të objektit etj. Kemi testuar 15 mostra për teste substanciale në vlerë 1,852,174€ si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 -Vonesë në furnizimin e pajisjeve të kontraktuara

Gjetja Bazuar në kushtet e kontratës për furnizim me pjesë PSR dhe MSSR mode M+S e nënshkruar me datën 31.12.2018 në vlerë 206,730€, ishte përcaktuar që afati i liferimi të pajisjeve do të bëhej 180 ditë nga data e lëshimit të urdhërblerjes nga autoriteti kontraktues.

Gjatë vitit 2019, ASHNA kishte paguar vlerën 165,348€ përmes dy pagesave, avansit 20,637€ si dhe pagesës 144,711€. Mirëpo për këto pagesa urdhërblerjet dhe zotimet ishin bërë pas pranimit të pajisjeve apo faturës. Kjo tregon që vlera prej 41,382€ nuk ishte furnizuar ende edhe përkundër që në kushtet e kontratës ishte përcaktuar që këto pajisje do duhej të furnizoheshin 180 ditë nga data e lëshimit të urdhërblerjes, e të cilat ASHNA nuk i kishte bërë me kohë.

Ndikimi Mos respektimi i kushteve të kontratës apo mos nxjerrja e urdhërblerjeve me kohë ndikon që furnizimi i pajisjeve të ketë vonesa dhe projekti të bartet për vitin tjetër duke ndikuar në funksionimin e sistemit të survijimit.

Rekomandimi A1 Drejtori të siguroj që furnizimet e kontraktuara bëhen brenda afateve të kontratës duke siguruar paraprakisht që procedurat apo hapat e zotimit dhe urdhërblerjes janë bërë me kohë.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 4,797,770€, pasurive jokatitale është 140,521€, si dhe e stoqeve 11,189€. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 986,689, si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Dobësi në raportimin e pasurive dhe mos regjistrimi i aseteve mbi 1,000 € në regjistrin kontabël të pasurive.

Gjetja Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rreg. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

Gjatë testimeve kemi vërejtur që ASHNA nuk kishte regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale mbi 1,000€ pagesën në vlerë prej 28,910€ për blerjen pajisjeve rezervë 4 copë power supply së bashku me instalimin e tyre në sistemet e radios VHF dhe UHF.

Vlen të theksohet që pasuria nën 1,000€ e prezentuar në PFV në vlerë 140,521€ nuk kishte kalkuluar shpenzimet e zhvlerësimit fare. Si e tillë pasuria nën 1,000€ është mbivlerësuar në PFV. Kjo ka reflektuar si rezultat i problemeve më sistemin e-pasuria.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës si dhe mbivlerësimi i pasurive nën 1,000€ reflekton me prezantim jo të drejtë të pasurisë në PFV-të e ASHNA-së.

Rekomandimi A2 Drejtori duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezentimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

2.3 Të arkëtueshmet

ASHNA-ja në PFV e vitit 2019 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 603,832€. Kjo vlerë përbehet nga shërbimet terminale të cilat kanë afat pagese 30 ditë, që pritet të inkasohen në fillim të vitit 2020. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 163,886€³. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Lidhur me detyrimet kemi identifikuar si më poshtë:

Çështja A3 - Vonesë në pagesë dhe dobësi në raportimin e obligimeve të papaguara

Gjetja Sipas rregullores financiare 02/2013 për Raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, neni 5 dhe 6, citon që raportet e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore duhet të dorëzohen në afat prej 15 ditë pas përfundimit të muajit, për gjendjen e muajit paraprak. Kurse sipas dispozitave të nenit 39, paragrafi 1, të LMFPP, obligim i vonuar për pagesë i organizatës buxhetore konsiderohet fatura e cila nuk është paguar 30 ditë pas pranimit të faturës.

ASHNA kishte raportuar çdo muaj në MF për obligimet e papaguara. Mirëpo në 6 pagesave apo fatura në vlerë 266,263€ kishte vonesë në pagesë deri afër dy muaj pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh. Prej tyre dy fatura në vlerë 8,212€ nuk ishin raportuar në raportin e obligimeve të papaguara për muajin shtator në MF.

Ndikimi Vonesa në pagesa dhe mos raportimi me kohë i obligimeve mujore ndikon në raportim jo të drejtë si dhe rrit rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë.

Rekomandimi A3 Drejtori duhet të siguroj kontrolle në raportimin e obligimeve mujore, ashtu që vlerat e sakta të raportohen për periudhat kohore dhe të përcillen nga muaji në muaj deri sa të paguhen.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019 ishte 1,001,975€. Këto janë obligime të ANP "Adem Jashari" SH.A të cilat kanë të bëjnë më tokë dhe marrëdhënie të punës. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

³ Kjo shumë është prezentuar nga entiteti i audituar

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Vlera e detyrime kontraktuale të ASHNA-së në fund të vitit 2019 ishte 2,020,217€⁴. ASHNA ka konfirmuar se është shfrytëzuese e kontratave të Agjencisë Qendrore të Prokurimit - AQP-së ku janë të përfshira të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

ASHNA ka njësinë e auditimit të brendshëm (NjAB), e cila përbëhet nga Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm. Mirëpo në vitin 2019 nuk kishte kryer asnjë raport të auditimit nga pesë auditimet e planifikuara në planin vjetor, për arsye që drejtoresha e NJAB-së kishte qenë në pushim të lehonisë. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të ASHNA ka rezultuar në 4 rekomandime kryesore. ASHNA kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 2 rekomandime janë zbatuar; 1 ishte mbyllur dhe 1 nuk ishte adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

⁴ Kjo shumë është prezentuar nga entiteti i audituar

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pasqyrat Financiare Vjetore	Drejtori duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, duke ndërmarrë veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe pasqyrimin e saktë të vlerës së pasurive jo financiare.	Edhe këtë vit kemi identifikuar gabime të keqklasifikimit	I pa zbatuar.
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës, të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit të buxhetit dhe të adresohen shkaqet për mos realizimin e buxhetit në nivel të planifikuar.	Nuk do të trajtohet në raport.	I mbyllur.
3	Pagat dhe mëditjet	Drejtori duhet që sigurojë që procedurat e rekrutimit të stafit të zhvillohen konform kriterëve të parashtruara në rregulloren e brendshme dhe konkurs duke respektuar dispozitat ligjore të shërbyesve civil.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla në këtë vit.	I adresuar.
4	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori duhet të rishikoj kontrollet ekzistuese për të siguruar menaxhim efikas të regjistrave të pasurive, konkretisht të harmonizojnë raportet e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive në përputhje me kërkesat rregullative.	Këtë vit kishte përgatitur raportin e inventarizimit me kohë.	I adresuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori duhet të siguroj që për të gjitha shpenzimet janë bërë planifikimet e duhura me kohë, në mënyrë që shpenzimi i tyre dhe regjistrimi të jetë në kategoritë e duhura ekonomike.		
2	Investime kapitale	Drejtori të siguroj që furnizimet e kontraktuara bëhen brenda afateve të kontratës duke siguruar paraprakisht që procedurat apo hapat e zotimit dhe urdhërbljes janë bërë me kohë.		
3	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezentimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.		
4	Detyrimet e papagura	Drejtori duhet të siguroj kontrole në raportimin e obligimeve mujore, ashtu që vlerat e sakta të raportohen për periudhat kohore dhe të përcillen nga muaji në muaj deri sa të paguhen.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR	
REPUBLIC OF KOSOVO		AGENCIJA ZA VAZDUŠNO NAVIGACIJSKE USLUGE	
REPUBLIC OF KOSOVO		AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY	
ZYRA E ARKIVES KANCELARIJA E SHËRBIMET ARCHIVES OFFICE			
Nr.faq.	01	Data	29.06.2020
Bz. str.		Date	
Pg. no.			
Nr. prot.	0174		
Bz. prot.		F.H	
Prot. no.			LIPJAN, RKS

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: "Etika - Co" SHPK

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Bahri Nuredini

Drejtor - Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Data: 29 Qershor 2020, Prishtinë,

